

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrustemi: PDK-ja e Aleanca të ndryshojnë qëndrimin për presidentin, pas verdiktit të 16 shtatorit
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/rrustemi-pdk-ja-e-aleanca-te-ndryshojne-qendrimin-per-presidentin-pas-verdiktit-te-16-shtatorit
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 01:23:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 15:03:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1fc3bb0f75ad1158fb2a2fa89fba2ef7816625ab3442abbd59a745210727c009
TEKSTI	7751a4f955b661c04240a915fd8bbc673e18c295e4a885b2d938044bbdd9f2b6
PAMJA	330f2812cf2587ae8679945830ea23b51b9c8ef2cc70aa9264fe4ea4796fe91b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c7ff6a2591380fe6d117a27f43b3d23262e31684dec084191ace8fe670716295
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5a460f22310e9ceafa1974b7e04989c7c6f3ec06c2b3e852ca0070c7b7986e17
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c7ff6a2591380fe6d117a27f43b3d23262e31684dec084191ace8fe670716295>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Rrustemi: PDK-ja e Aleanca të ndryshojnë qëndrimin për presidentin, pas verdiktit të 16 shtatorit



24 shtator 2026 17:03

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Deputeti i Vetëvendosjes, Adnan Rrustemi, ka shprehur pritje që Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca do të ndryshojnë qëndrimin për çështjen e zgjedhjes së presidentit, pas 16 shtatorit kur Gjykata Speciale dënoi me 81 vjet burgim katër ish-udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Këto dy parti patën refuzuar negociatat me Vetëvendosjen për çështjen e presidentit. E të mërkurën, Gjykata Kushtetuese bëri të ditur se partitë kanë afat deri më 6 tetor për të zgjedhur presidentin. E sipas Rrustemit, situata e krijuar pas verdiktit të Speciales, duhet të ndikojë edhe në ndryshime për çështjen e formimit të institucioneve.

“Këto 12 ditë janë 12 ditë për presidentin. Vërtetë është shkurtuar mjaft shumë afati, por secila parti politike duhet ta ketë parasysh se kjo është gjëja më e rëndësishme për t'i dhënë vendit stabilitet dhe për t'i shmangur zgjedhjet që të pajtohemi për presidentin konsensual. Kosova ka nevojë për president, nuk ka nevojë për zgjedhje të reja. Dhe ka nevojë për një president konsensual dhe kështu t'i krijojë mundësinë për stabilitet institucional dhe të përballat me të gjitha sfidat, me punët natyrisht që na presin edhe ato që u përmendën. Do të habitesha shumë që edhe pas 16 shtatorit, nëse partitë politike opozitare kanë qëndrimet e njëjta sikurse para 16 shtatorit. Unë mendoj që pas 16 shtatorit secila parti politike opozitare që ka kalkulluar për ta pamundësuar Qeverinë Kurti duke kufizuar në mandat nëpërmjet procesit të zgjedhjes së presidentit të Republikës, duhet të reflektojë dhe duhet të ulemi dhe të gjejmë një konsensus për sa i përket presidentit dhe pastaj të vazhdojmë punën, natyrisht secili në rolin dhe pozicionin e tij apo të saj”, ka thënë Rrustemi për KosovaPress.

Rrustemi ka shtuar se tejkalimi i çështjes së presidentit do t'i mundësonte Kosovës të kishte institucione stabile dhe me mandat të plotë për t'u përballur me sfidën e Speciales dhe për t'i ofruar mbështetje të plotë shtetërore, me strategji të bashkërenduar, 4 ish-krerëve të UÇK-së.

Arbëri.

Arifi për vendimin e Speciales: Agresion politik me mjete juridike

Futboll.

Kosova U21 mposht bindshëm San Marinon

Futboll.

Foda i lumtur me fitoren, pret mbështetjen e shqiptarëve në Vjenë

Kulturë.

Gjetjet arkeologjike në Tepelenë – dëshmi e jetës në antikitet

Futboll.

Muriqi: Fitore për çlirimtarët dhe UÇK-në

Futboll.

Përzgjedhësi i Irlandës: Kosova e meritoi fitoren

Rrustemi ka komentuar edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë një ditë më parë konstatoi se konstituimi i Kuvendit është kryer përtej afateve, se formimi i Qeverisë nuk është antikushtetues dhe caktoi 6 tetorin si datë të fundit për zgjedhjen e presidentit.

Edhe



Arbëri • 6 o. më parë

Kushtetuesja vë në lëvizje institucionet

“Vetë Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e kaluar, për sa i përket shpërndarjes së Kuvendit, që ndërlidhej me zgjedhjen e presidentit të Republikës, e kishte thënë decidivisht, shprehimisht që procedura e zgjedhjes së Presidentit të Republikës fillon nga momenti i konstituimit të Kuvendit. Nuk mund t'i bartet një përgjegjësi institucionit dhe deputetëve, për sa kohë institucioni nuk është i fuqplotë dhe nuk ka kapacitet. Domethënë, ne e kemi pasur të pamundur të nisim procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës pa u konstituuar Kuvendi. Vetëm nga momenti i konstituimit duhet të fillojë dhe të rrjedhë ky afat. Megjithatë, e kemi këtë interpretim të çuditshëm të Gjykatës Kushtetuese, që e ka shkurtuar dukshëm periudhën dhe përpjekjen, natyrisht, për ta gjetur një president konsensual”, deklaroi Rrustemi.

I pyetur se mund të bëhet një kompromis me PDK-në që të sigurohen votat për president duke miratuar ndryshimet ligjore për Gjykatën Speciale, ai ka thënë se çështja e Gjykatës Speciale nuk duhet të trajtohet përmes kalkulimeve politike të ditës.

“Unë jam kundër që çështjen e Gjykatës Speciale ta trajtojmë me kalkulime politike të politikës ditore. Domethënë, unë ta bëj këtë, e ju ma bëni këtë e të tjerë e të tjerë. Me Gjykatën Speciale duhet të përballemi si shtet, si shoqëri, si institucione, me një strategji shtetërore të bashkërenduar dhe, natyrisht, me parashikueshmëri të qartë të veprimeve dhe të dobishmërisë së këtyre veprimeve. Prandaj është shumë e rëndësishme që të kemi institucione stabile të fuqiplota. Domethënë, ne e kemi tepër të vështirë, po e them këtë edhe si shqetësim edhe si qytetar para së gjithash, që të përballemi me këtë betejë që na prek të gjithëve, që është përtej secilës palë, nëse nuk kemi institucione stabile. Prandaj është shumë e rëndësishme që ta zgjedhim Presidentin e Republikës së Kosovës, të vazhdojë puna e institucioneve me mandat të plotë dhe të fillojmë një punë të përbashkët përtej dallimeve politike për t'u përballur me këtë gjykatë të padrejtë e me proces të padrejtë, pa asnjë dyshim. Në anën tjetër, këto janë 12 ditë, tash ju secili mund ta merrni me mend se çfarë pune mund të bëhet në Kuvend të Kosovës në 12 ditë, me procedurat që ekzistojnë e kështu me radhë”, ka thënë ai.

Gjykata Kushtetuese po ashtu u ka kërkuar deputetëve që sa më parë ta zgjedhin nënkryetarin e Kuvendit nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar, pra të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

PDK-ja pas zgjedhjeve të 7 qershorit ka thënë se do të qëndrojë në opozitë dhe nuk do të përfshihen në negociatat për zgjedhjen e presidentit. Ndërkaq, Aleanca ka vendosur disa kërkesa, mes tyre edhe pranimin e gazit amerikan për të mbështetur zgjedhjen e presidentit.

Edhe



LAJMET E MBRËMJES • 23 sht 2026

PDK-ja kërkon mbledhjen e menjëhershme të Kuvendit. LVV-ja fajëson opozitën nëse shkohet në zgjedhje

PDK-ja pati tërhequr emrin nga nominimi për nënkryetar, pasi pushteti fillimisht nuk e mbështeti emrin e Vlorë Çitakut. Kjo parti më pas çoi në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit edhe pa votimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e saj, por edhe votimin e Qeverisë.

Ndërkaq, pas vendimit të Gjykatës Speciale për dënimin e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit e Rexhep Selimit, PDK-ja inicioi ndryshimin e Ligjit për Specialen.

Artikuj të ngjashëm

- 

Arbëri

• 16 kor 2026

Rrustemi: Po i japim kohë bisedimeve, prandaj s'po thirret seanca konstituive
- Arbëri

• 30 qer 2026

Garë për president mes Haradinajt e një kandidati të VV-së, Rrustemi: Eliminon problemin e kuorumit
- Arbëri

• 28 qer 2026

Rrustemi: PDK-ja po e pengon çdo afrim mes LDK-së dhe Vetëvendosjes

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë